

URDHËR
Nr. 687, datë 12.9.2024

PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË
MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në proceset gjyqësore kur thirret si palë në gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit/personave që do të përfaqësojnë ministrinë.

2. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri, si pjesë përbërëse e tij.

3. Nënshkrimi i akteve procedurale, të tilla si: kërkesëpadi, prapësime, deklarata mbrojtje, pretendime, ankime, rekurse, paraqitje të kërkesave, si dhe çdo veprim procedural të nevojshëm, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit, bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

4. Përfaqësuesit e autorizuar të ndjekin me korrektesi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre, në çështjet ku Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është palë ndërgjyqëse.

5. Përfaqësimi për proceset gjyqësore bëhet nga juristë të Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore si dhe specialistë të fushës për të cilën është ngritur kërkesëpadia, nëpërmjet autorizimit përkatës.

6. Ngarkohen të gjitha strukturat e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për të shkëmbyer çdo informacion të nevojshëm, dhënie mendimi teknik apo vendosjen në dispozicion të dokumentacioneve, me Sektorin e Këshillimit, të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

7. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme, me qëllim paraqitjen e tyre konform ligjit, në cilësinë e provave materiale për proceset gjyqësore.

8. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Këshillimit, të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2024

AUTORIZIM PËR PËRFAQËSIM NË ÇËSHTJEN GJYQËSORE

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil si dhe neneve 92, 96 të Kodit të Procedurës Civile të ndryshuar,

VENDOSA:

Autorizimin e _____ për të përfaqësuar Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, së bashku ose veç e veç, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, në çështjen gjyqësore Nr. _____, në mbrojtje të interesave të saj me palë ndërgjyqëse si vijon:

Paditës: _____

Të paditur: _____

Objekti: _____

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Alketa Përnaska